

**Inspektorati Policor i Kosovës** është institucion përgjegjës për sigurimin e **llogaridhënies dhe profesionalizmit të Policisë së Kosovës**. Ushtrimi i suksesshëm i këtyre kompetencave nga IPK-ja do t'i sigurojë të gjitha komunitetet në Kosovë se PK-ja mund dhe do të marrë përgjegjësi, qoftë kolektivisht apo individualisht, duke punuar në mënyrë aktive për të ofruar shërbime dhe për të mbështetur një mjedis të sigurt dhe stabil.

*Kjo broshurë është përgatitur nga OJQ ACDC në kuadër të projektit të financuar nga UNMIK-u, projekt i cili synon ngritjen e vetëdijes për të drejtat e banorëve në kontekstin e procedurave dhe rregulloreve për qasjen dhe korrigjimin e mekanizmave të disponueshëm përmes Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK). Përmbajtja e shprehur në këtë broshurë është përgjegjësi e vetme e OJQ ACDC dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNMIK-ut.*



**Advocacy Center**  
for **Democratic Culture**

# ROLI DHE MISIONI I INSPEKTORATIT POLICOR TË KOSOVËS (IPK)



## Funksionet:

Funksionet kryesore të Inspektoratit Policor të Kosovës përfshijnë parandalimin, zbulimin dhe dokumentimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e forcave policore.

## Misioni:



Ofrimi i shërbimit policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me ligjet në fuqi dhe standardet e kërkuara.

## Objektivi:

Të jetë lider kombëtar në ekzekutimin e kompetencave mbikëqyrëse për parandalimin e keqmenaxhimit, korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera kriminale brenda Policisë së Kosovës, të gjitha me qëllim të rritjes së besimit në zbatimin e ligjit.

## Vlerat:

- ✓ profesionalizmi,
- ✓ objektiviteti,
- ✓ paanshmëria politike,
- ✓ mosdiskriminimi dhe
- ✓ respektimi i të drejtave të njeriut.



Një nga objektivat strategjike të IPK-së është t'u ofrojë qytetarëve shërbime gjithëpërfshirëse, koncize dhe konkrete.

## Si të raportoni:

→ nëpërmjet një formulari ankese online, ku qytetarët mund ta plotësojnë dhe ta dorëzojnë nëpërmjet faqes zyrtare të internetit.

[www.ipk.rks-gov.net](http://www.ipk.rks-gov.net)



→ përmes linjës telefonike 'blu' pa pagesë në:



**080003333**

